



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr. 53/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Skender Çoçaj kryesues, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës PDK, me seli në Prishtinë, dega Mitrovicë e Jugut, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, dega Mitrovicë e Jugut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 23.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

Hedhet e palejuar ankesa e parashtruar nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës PDK, me seli në Prishtinë, dega Mitrovicë e Jugut, ZL.A.nr.53/2025 e datës 22.09.2025, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, dega Mitrovicë e Jugut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 22.09.2025 PZAP-i, përmes postës ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik PDK, me seli në Prishtinë, dega Mitrovicë e Jugut, në të cilën pretendon se më datë 16.09.2025, kandidati për kryetar të Komunës së Mitrovicës së Jugut nga radhët e Subjektit Politik Guxo/LVV, Faton Peci, ka zhvilluar aktivitete të fushatës zgjedhore në institucione publike konkretisht ka zhvilluar vizitë në Muzeun e Qytetit të Mitrovicës, i cili ishte pritur nga drejtoresha e këtij institucioni.

Më tej në ankesë theksohet se ky veprim i tij dëshmohej, nga statusi dhe fotografitë e publikuara në faqen zyrtare në rrjetin social facebook, të kandidatit Faton Peci.

Parashtruesi i ankesës pretendon se këto veprime bien ndeshë me disa dispozita ligjore në fuqi, konkretisht me LZP dhe rregullat zgjedhore.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur fotografi të shkëputura nga rrjeti social facebook.

Në përgjigjen në ankesë të Subjektit Politik LVV, theksohet se në ankesën e dorëzuar pretendohet nga Subjekti Politik PDK, se z. Faton Peci, kandidat i Lëvizjes VETËVENDOSJE! Për kryetar të Komunës së Mitrovicës, në cilësinë e deputetit dhe ministrit në detyrë, ka shkelur nenin 36 të Ligjit Nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Më tej në përgjigje LVV, sqaron se rrethanat faktike dhe pretendimet e paraqitura në këtë ankesë, janë identike me ato që tashmë janë shqyrtuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, i cili ka vendosur me vendimin ZL.Anr.44/2025 të datës 20.09.2025, kjo çështje përben res judicata.

Prandaj, kërkojnë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që të hedhë poshtë ankesën si të palejuar.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e ankesës gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga Subjekti Politik PDK, ka njëjtësi objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën ZL.Anr.44/2025 të paraqitur me datën 18.09.2025 nga po i njëjti Subjekt Politik PDK, kundër subjektit politik LVV, e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it, ZL.Anr.44/2025 të datës 20.09.2025, Subjektit Politik PDK i është miratuar ankesa si e bazuar.

Ndërsa pas shikimit dhe krahasimit të shkresave të lëndës qëndrojnë të bazuara pretendimet në përgjigje në ankesë se lidhur me këto pretendime ankimore PZAP-i, ka vendosur me vendimin ZL.Anr.44/2025 të datës 20.09.2025.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, ZL.Anr.44/2025 të datës 20.09.2025 dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli e hedhi ankesën.

Prandaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura lart, në pajtim me nenin 115 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 paragrafi 5 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZLAnr.53/2025 më datën 23.09.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.